
 Republika e Kosovës Republika Kosovo	<b>Zyra e Personelit</b> <b>Kancelarija Osoblja</b>		 Komuna e Istogut Opština Istok
	02 Nr.230/19	Data: 17.09.2019	

Menaxheri i Personelit në pajtim me dispozitat e ligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës nr. 03/L-149 dhe dispozitave të Rregullores nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, bëhet ky:

### NJOFTIM

Meqenëse nuk është arritur numri i ballancuar i kandidatëve sipas përfaqësimit etnik dhe gjinor, i përcaktuar në Ligjin Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, zgjatet afati edhe për 7 ditë i konkursit 02 Nr.208/19 i datës 02.09.2019 i publikuar në të përditshmen "Bota Sot" me 02.09.2019 për plotësimin e vendit të lirë të punës:

- Zyrtar/e për Standarde, Monitorim dhe Vlerësim

Të gjitha kushtet dhe kriteret si dhe përshkrimi i punëve dhe detyrave, të cilat janë publikuar në konkursin e cekur janë të vlefshme.

" Shërbimi Civil i Kosovës u shërben të gjithë banorëve të Kosovës dhe mirëpret aplikimet nga femrat dhe meshkujt e të gjitha komuniteteve të Kosovës ".

Kandidatët e interesuar mund t'i marrin formularët e aplikacioneve s'i dhe t'i dorëzojnë dokumentacionet e kompletuara për çdo ditë pune në zyrën nr.304 ( tek Udhëheqësi i Personelit ), në ndërtesën e Komunës së Istogut.

Me kandidatët të cilët kanë konkuruar, do të bëhet intervista nga komisioni, nërsa për datën dhe kohën e mbajtjes së intervistës, kandidatët do të njoftohen me kohë.

Kandidatët të cilët kanë konkuruar sipas afatit të rregullt nuk janë të obliguar të konkurojnë sërish.

**Vërejtje:** Dokumentet e pa kompletuara, si dhe parashtrimi i kërkesave pas skadimit të afatit të përcaktuar, nuk do të shqyrtohen



Menaxheri i Personelit,  
**Fatmir Bytyçi**